



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 15,26 dhe Kreun 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Nenit 3 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;dhe
4. Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 20.08.2008 nga ndërmarrja “RE Trading CEE s.r.o”, adresa: Ke Stvanici 3/656 Pragë, Republika Çeke.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

1. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes “RE Trading CEE s.r.o”.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 20.08.2008 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike nga ndërmarrja “RE Trading CEE s.r.o”.
2. Gjatë vlerësimit fillestar të aplikacionit janë vërejtur disa mangësi si në kompletimin e dëshmive ashtu edhe në përmbajtjen e tyre, e të cilat mangësi janë eliminuar nga aplikuesi, pas kërkesave të bëra nga ZRRE.
3. Pas kompletimit të aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe çdo dëshmi të dërguar nga ndërmarrja RE Trading CEE s.r.o, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Kjo licencë i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.
5. Nëse i licencuari dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të furnizimit me energji elektrike të përcaktuara me nenin 4 të licencës, atëherë i njëjti duhet të ri-aplikojë në ZRRE dhe të përmbushë obligimet tjera të përcaktuara me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.
6. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar